



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2019

Lënda: Kthim përgjigje.

Në përgjigje të Kërkesës për informacion administruar pranë Bashkisë Shkodër me nr 10524 prot dt 19.06.2019 , ku kërkoni të informoheni mbi Lejen Minerare të gurores në fshatin Milan , ju informojmë si vijon : Bashkia Shkodër ka dijeni mbi aktivitetin e gurores që ushtrohet në zonën e Postribës fshati Domen, Milan.

Aktiviteti që ushtrohet është i pajisur me Leje Minerare , ju informoj se kjo/këto leje minerare nuk miratohen nga Bashkia Shkodër , por nga ministria përkatëse, kjo bazuar në pikën 2, 16 të nenit 2 të Ligjit nr 10304/2010 “ Për sektorin minerar në RSH” i ndryshuar, pavarësisht se aktiviteti i tyre ushtrohet në territorin administrativ të Bashkisë.

Shoqëria “Babasi COO” shpk me shkresën nr 234/17-9 prot dt 29.09.2017 , administruar pranë Bashkisë Shkodër me nr prot 14607 prot dt 02.10.2017 , njofton Bashkinë Shkodër se është pajisur me Lejen Minerare nr 1835 dt 30.06.2017 “ Për hapjen dhe shfrytëzimin e gëlqerorëve të mermerizuar për objektin Rasek , fshati Domen NJA Postribë”, leje kjo e dhënë nga Ministria e Industrisë dhe Energjisë , bashkëlidhur së cilës ka vendosur edhe Lejen e Mjedisit nr 2618 , nr 4145 prot dt 22.05.2017, leje kjo miratuar nga Ministria e Mjedisit , Agjensia Kombëtare e Mjedisit, etj (bashkëlidhur kopje të tyre)

Me shkresën nr 10 dt 25.04.2018 administruar pranë Bashkisë Shkodër mr nr 6170 dt 25.04.2018 , Shoqëria “ NGA GROUP” shpk paraqet dokumentacionin në të cilin njihet si Nënkontraktor i shoqërisë “ Babasi COO” shpk, nënkontraktim ky i miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr 4809/1 prot dt 24.04.2018. (bashkëlidhur shkresa).

Lidhur me përgjigjen e pyetjes Tuaj nëse mund të ngrihej kjo gurore ose jo .. duke qënë se lejet janë miratuar nga Ministritë përkatëse , jeni e lutur ti drejtoheni këtyre institucioneve për një informacion më të detajur.

Ju informojmë se bazuar në nenin 2 pika 2 dhe neni 24 pika 1 të Ligjit nr 10304/2010 i ndryshuar “ Për sektorin minerar në RSH” Për cdo punim apo ndërhyrje e cila realizohet

nga subjektet brenda sipërfaqes të parashikuar në Lejen e Shfrytëzimit” nëse keni ankesë duhet ti drejtoheni organeve të cilat kanë dhënë Lejen Minerare të shfrytëzimit .

Bashkia Shkodër duke qënë se ky aktivitete ushtrohet në territorin e saj , në zonë pyjore/kullosore me shkresën nr 179 prot dt 07.01.2019 i është drejtuar Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore të pezullojë aktivitetin e këtij subjekti deri në heqjen e kësaj sipërfaqe nga fondi pyjor/kullosor i Bashkisë Shkodër. (bashkelidhur kopje).

Zv/KRYETAR

Arben GJURAJ